

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lirohet Ilias Kasidhiaris, ish-"numri 2" i Agimit të Artë synon rikthimin në politikën greke
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/lirohet-ilias-kasidhiaris-ish-numri-2-i-agimit-te-arte-syno-n-rikthimin-ne-politiken-greke/1012302/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:53:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:49:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4d5240c79a7f77196369d8a0a6fb8890e3f1a572489e968ce608926becf4763d
TEKSTI	278835155c6153c288c2ff8d8b4cdd912ff5bb29074082e4eaa478b3a18f56a8
PAMJA	213ea10bbc41317465630da551cd2154f979a0466fde87eb35f1ee081cb33d9c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac83a9101eba925b3aa79b03b815064cb04d1cde5adddc91758932ddacfd3324
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.


<https://scan.stamles.eu/verify/ac83a9101eba925b3aa79b03b815064cb04d1cde5adddc91758932dda-cfd3324>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lirohet Ilias Kasidhiaris, ish-“numri 2” i Agimit të Artë synon rikthimin në politikën greke



Ilias Kasidhiaris, një prej drejtuesve më të rëndësishëm të Agimit të Artë dhe për shumë vite krahu i djathtë i liderit Nikos Michaloliakos, ka lënë sot burgun e Domokosit pasi përfundoi dënimin për drejtimin e një organizate kriminale.

Gjykata e Apelit në Athinë e kishte dënuar me 13 vjet burg, pas konfirmimit të vendimit historik se Agimi i Artë vepronte si një “organizatë kriminale nën petkun e një partie politike”. Për të njëjtën vepër u dënuan edhe Nikos Michaloliakos, Giannis Lagos, Christos Pappas, Giorgos Germanis, Ilias Panagiotaros dhe Artemis Matthaopoulos.

Sipas avokates së tij, lirimi u bë i mundur pasi Kasidhiaris ka shlyer të gjithë dënimin, në përputhje me mënyrën e përlllogaritjes së përcaktuar nga kodi penitenciar. Ai ka qëndruar realisht rreth shtatë vjet në burg, duke përfshirë edhe periudhën e paraburgimit, ndërsa afërsisht gjashtë vite të tjera janë llogaritur përmes punës së kryer gjatë vuajtjes së dënimit. Në raste të tilla, një ditë pune mund të konsiderohet si më shumë se një ditë burgimi.

Kasidhiaris e ka mbajtur aktive praninë e tij publike edhe gjatë qëndrimit në qeli. Nga burgu i Domokosit ai ka komunikuar me mbështetësit përmes rrjeteve sociale, videove dhe transmetimeve në internet, duke sinjalizuar vazhdimisht synimin për t'u rikthyer në politikë.


Aktiviteti i tij politik u shfaq edhe në zgjedhjet e vitit 2023, kur tentoi të merrte pjesë përmes partisë “Ellines” (Grekët). Gjykata e Lartë e ndaloi pjesëmarrjen e këtij formacioni, duke e cilësuar Kasidhiarin si drejtuesin e tij real. Më pas ai mbështeti partinë “Spartiates”. Në qershor të vitit 2025, Gjykata e Posaçme Zgjedhore u hoqi mandatet tre deputetëve të kësaj partie, me arsyetimin se votuesit ishin mashtruar dhe se drejtuesi i fshehtë, si edhe udhëzuesi real i saj, ishte Ilias Kasidhiaris.

Ndërsa ndodhej në burg, ai u zgjodh gjithashtu këshilltar bashkiak në Athinë në vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe,

të fundit /



Bekteshi: Gjashtë vota mund të vendosin mes presidentit dhe...



Operacion i AMP-së në Durrës, arrestohet në flagrancë një efektiv...



Administrata e Gjykatës së Kukësit në bojkot për pagat, vijojnë vet...



Kategoria e Parë zhvillon javën e tretë, të gjitha ndeshjet luhen...



Keith Self paralajmëron Hagën: Vendimi për Thaçin të mos ndikoh...



Tërmkolli kundërshton retorikën kërcënuese para vendimit të Hag...



Ndahet nga jeta Flora Brovina në moshën 76-vjeçare



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Kasidhiaris vazhdoi të mbanie kontakte me perkranesit dhe te paraajmeronte rikthimin ne skenen politike.

Pruga e Agimit të Artë drejt parlamentit nisi fuqishëm në vitin 2012, në kulmin e krizës ekonomike dhe politike në Greqi. Në zgjedhjet e qershorit të atij viti, partia mori 6,92% të votave dhe siguroi 18 vende deputetësh. Në vitin 2015 ajo ruajti thuajse të njëjtin nivel, me rreth 7% të votave dhe 18-19 deputetë. Në zgjedhjet e vitit 2019, megjithatë, rezultati ra nën pragun prej 3%, duke e lënë jashtë Parlamentit.

Hetimi ndaj organizatës mori një kthesë vendimtare pas vrasjes së muzikantit antifashist Pavlos Fyssas në shtator 2013. Për vrasjen, e kryer nga Giorgos Roupakias, anëtar i organizatës, pasoi një proces gjyqësor që zgjati disa vite. Në vitin 2020, gjykata shpalli fajtorë të gjithë 18 ish-deputetët e grupit parlamentar të Agimit të Artë: shtatë prej tyre për drejtimin e organizatës kriminale dhe 11 për anëtarësim në të.

Në shkallën e dytë të gjykimit, në mars 2026, u shpallën fajtorë të gjithë 42 të pandehurit që kishin vijuar procesin e apelit.

Tani debati kryesor lidhet me mundësinë që Kasidhiaris të rikthehet si kandidat. Ai vetë ka deklaruar se po del nga burgu me "të drejta të plota politike" dhe ka njoftuar një konferencë shtypi ku do të prezantojë planet e tij për të ardhmen. Avokatja e tij ka deklaruar se pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme është e sigurt.

Megjithatë, aspekti ligjor mbetet i hapur. Ligji i miratuar në vitin 2023 ndalon pjesëmarrjen në zgjedhje të atyre formacioneve, drejtuesi real i të cilave është dënua për drejtim ose anëtarësim në një organizatë kriminale. Juristët kanë interpretime të ndryshme për kohëzgjatjen e këtij kufizimi: disa nuk janë të sigurt nëse ai përfundon me lirin e Kasidhiaris nga burgu apo nëse zgjat deri në përfundimin formal të dënimit.

Vendimin përfundimtar do ta marrin përsëri gjyqtarët e seksionit politik të Gjykatës së Lartë. Ata do të përcaktojnë nëse Kasidhiaris mund të drejtojë një parti, të kandidojë për deputet apo të jetë drejtuesi real i një formacioni tjetër politik.

Kjo është edhe çështja që po diskutohet gjerësisht nga mediat greke. Gazeta "Efimerida ton Syntakton" shkruan se Kasidhiaris ka punuar prej muajsh për kthimin në politikë dhe se synimi i tij është "normalizimi institucional" i pranisë publike. Këtë herë, sipas gazetës, ai nuk do të mbështetet te brigadat e sulmit në rrugë, por kryesisht te rrjetet sociale dhe ndikimi mbi një pjesë të elektoratit, veçanërisht te të rinjtë.

Lirimi i tij, që vjen vetëm pak ditë para përvjetorit të vrasjes së Pavlos Fyssas, e rikthen në qendër të debatit politik grek pyetjen nëse një prej drejtuesve kryesorë të Agimit të Artë mund të rifitojë një rol politik pasi ka përfunduar dënimin penal.

Rikthimi i Kasidhiaris ndodh vetëm pak muaj para zgjedhjeve parlamentare, në një periudhë kur politika greke është më e fragmentuar se kurrë. Demokracia e Re vazhdon të jetë forca kryesore, por po përballët me pakënaqësi të mëdha. Në të djathtë të saj garojnë disa parti konservatore dhe formacione të ekstremit të djathtë.

Ndërkohë, partitë progresiste dhe ato të qendrës së majtë vijojnë të jenë të përçara dhe nuk kanë ndërtuar një alternativë të vetme të qartë për qeverisje. Për më tepër, ato përjashtojnë mundësinë e bashkëpunimit. Në këtë klimë, Kasidhiaris synon të rikthehet duke e paraqitur veten jo përmes simbolikës së hapur neonaziste të Agimit të Artë, por me një retorikë "patriotike", antisistem dhe kundër elitave politike.


Disa media greke paralajmërojnë pikërisht për mundësinë që "historia të përsëritet – si farsë ose si tragjedi". Në vitin 2012, Agimi i Artë shfrytëzoi zemërimin e shoqërisë, krizën ekonomike dhe humbjen e besimit të partitë tradicionale për të hyrë në parlament.

Greqia e sotme nuk është në të njëjtat kushte, por disa prej faktorëve që ushqyen atëherë ekstremizmin janë ende të pranishëm. Pakënaqësia, rritja e çmimeve të ushqimeve, karburanteve dhe qirave, si edhe skandalet politike, po nxisin sërish kërkimin e një vote ndëshkuese. Pyetja mbetet nëse kthimi i Kasidhiaris do të jetë vetëm një zhvillim periferik në politikë apo nëse ai do të ndikojë përsëri në ekuilibrat e së djathtës së skenës politike greke.

Shtuar më 15.09.2026 11:49



Ish-zëvendësi i Agimit të Artë lirohet nga burg, paralajmëron rikthimin



Bill Gates paralajmëron për IA-në: Qeveritë e botës nuk janë të përgatitura për



Përshkallëzohen tensionet në ujërat ndërkombëtare, frapato rreth drejtës dhe



Trump përmbys kursin klimatik të Bidenit, hap

paradajmeron nxënësit...

janë të përgatitura për...

negociatë ruse drejton dy...


rugën për më shumë...



Kina zgjeron kufizimet e udhëtimit, qytetarët rrezikojnë të mos lejohen...



Lufta me Iranin zbraz rezervat amerikane të municioneve, kostoja shk...



Avionët luftarakë të NATO-s rrëzojnë një dron pasi hyri në hapësirën ajrore të...



Vala e re e sulmeve të Huthëve ndaj Arabisë Saudite rrit rrezikun e...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.